



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të kreut XIII, XVII, XI dhe nenit 64.2 pika (a), (b), (83) dhe 128.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligjit nr. 03/L-256 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe kreut XIII, dhe nenit 20 Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datë 02.07.2013, nxjerr:

RREGULLËN ZGJEDHORE Nr. 16/2013 PËR THEMELIMIN E QENDRAVE TE VOTIMIT

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

Qëllimi i kësaj rregulle është: përcaktimi i kriterëve teknike për vendndodhjen e lokacioneve të qendrave të votimit dhe vendvotimeve, procedurat për themelimin si dhe publikimi i Qendrave të Votimit.

Neni 2

Përkufizimet

- 2.1 **Qendra e votimit (QV)** - është ndërtesa në të cilën ndodhen një ose më shumë Vendvotime për qëllim të votimit në zgjedhje dhe përfshinë një hapësirë publike dhe private brenda hapësirës prej 25 metra.
- 2.2 **Vendvotimi (VV)** - do të thotë një dhomë, sallë ose objekt i ngjashëm për qëllime të votimit në ditën e zgjedhjeve.
- 2.3 LPV-ja e votuesve që caktohen në QV-në e njëjtë do të ndahet nëpër VV-të e veçanta me renditje alfabetike sipas mbiemrit. VV nuk duhet të tejkalojë numrin prej 750 votuesve. Përfshirjet nga kjo rregull mund të rekomandohen - autorizohen nga Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për t'u shërbyer më mirë interesave të votuesve.

- 2.4 Vendvotimi i fundit në çdo QV do të shërbejë si VV për votimin me kusht dhe quhet vendvotimi i dyfishtë (VVD). Në QV-në me një VV, i njëjti VV do të shërbejë edhe për votim me kusht.
- 2.5 Në çdo VV duhet të caktohet një Këshill i Vendvotimit (KVV) i cili do të udhëheq dhe mbikëqyr procesin e votimit, dhe numërimit.
- 2.6 Çdo QV duhet të ketë nga një menaxher të QV-së dhe stafin tjetër ndihmës, i cili duhet të sigurojë që QV-ja të jetë e përgatitur për ditën e zgjedhjeve, të sigurojë qasje në QV dhe të ndërlihet me KKZ-në sa i përket përgatitjes logjistike për në QV dhe anasjelltas.

Neni 3

Kriteret teknike për vendndodhjen e Qendrave të Votimit

- 3.1 Vendndodhja e Qendrës së Votimit (QV), duhet të plotësojë kushtet si në vijim:
- a) Hapësirë duhet të jetë në sipërfaqe minimum 95 m² për QV dhe 32 m² për VV;
 - b) objekti/ndërtesa të ketë jo më pak se një dhomë;
 - c) objekti/ndërtesa duhet të ketë se paku një hyrje;
 - d) objekti /ndërtesa duhet të ketë ndriçim të mjaftueshëm;
 - e) QV nuk mund të jetë më lart se në katin e dytë (2) të objektit/ndërtesës;
 - f) duhet të ketë qasje të lehtë për votim të personave me aftësi të kufizuara;
 - g) objekti duhet të ketë tavolina dhe karrige;
 - h) të ketë se paku një tualet;
 - i) të ketë në rregull energjinë elektrike;
 - j) të ketë parking.

Neni 4

Vendndodhja e lokacioneve të Qendrave të Votimit dhe Vendvotimeve

- 4.1 Qendër e Votimit është vend i caktuar për zhvillimin e procesit të votimit në përputhje me Ligjin mbi zgjedhjet e Përgjithshme dhe Lokale.

Qendrat e Votimit themelohen në:

- a) Ndërtesa të institucioneve publike; arsimore, kulturore, sportive etj;

- b) Ndërtesa private në pronësi të personave fizikë ose juridikë, vetëm pas miratimit nga KQZ-ja kur nuk është e mundur sipas pikës (a) të këtij paragrafi;
- c) Ne institucione te posaçme ku përfshihen: Qendrat e Paraburgimit, Burgjet dhe spitalet ose institucionet tjera shëndetësore.

Neni 5

Procedurat për themelimin e Qendrave të Votimit dhe Vendvotimeve

- 5.1 Sekretariati i KQZ-se përmes ZLKZ-së në vitet zgjedhore kujdeset që të bëjë analizën dhe vlerësimin e Qendrave aktuale të Votimit, por që mund të propozojë edhe për mundësinë e themelimit të Qendrave te Reja te Votimit.
- 5.2 Në bazë të nenit 83 të LZP, mundësisht asnjë votues, nuk duhet të udhëtoj më shumë se 3 km deri në vendvotimin e tij/saj.
- 5.3 Si rezultat i vlerësimit të nevojave dhe mundësive teknike për themelimin e Qendrave te Reja te Votimit, SKQZ-ja ndërmerr veprimet e nevojshme dhe i rekomandon KQZ-se për themelimin e Qendrave te Reja te Votimit.
- 5.4 Kërkesat për themelimin e Qendrave të Reja te Votimit mund të bëhen nga bashkësitë lokale, administratoret apo kryetaret e fshatrave, qytetaret apo subjektet politike në zyrën e KKZ-së.
- 5.5 Mbështetur në pikën 5.3 të këtij neni, KKZ rekomandon SKQZ/KQZ-se për themelimin e Qendrave te Reja te Votimit përmes Formularit (bashkangjitur kësaj Rregulle). Jo më vonë se dhjetë (10) ditë pas emërimit të KKZ-se nga KQZ-ja.
- 5.6 Sekretariati pas analizave të KKZ për themelimin e Qendrave te reja, i paraqet KQZ-së kërkesën për themelimin e Qendrave te Reja te Votimit, KQZ merr vendim brenda dy (2) ditëve, nga pranimi i kërkesës për themelimin e Qendrave te Votimit.
- 5.7 KQZ gjithashtu informon votuesit për çdo ndryshim të lokacionit të QV-se përmes mediave vendore dhe ueb faqes zyrtare. Përveç kësaj, KKZ-ja do të vendosë një njoftim në lokacionin fillestar të QV-së me të cilin i njofton votuesit për lokacionin e ri të QV-së.

Neni 6

Kriteret teknike për themelimin e hartave të Qendrave te Votimit

- 6.1 Institucioni i KQZ-se duhet të pajiset me hartën e Republikës së Kosovës në përgjithësi në formë fizike dhe digjitale.

- 6.2 SKQZ duhet të pajiset me hartat e disponueshme për secilën komunë me kufijtë administrativë, pozicionin e të gjitha qyteteve, lagjeve urbane, vendbanimeve, rrugët me emrat e rrugëve, fshatrave dhe ndërtesave apo objekteve publike dhe të dhënat tjera të nevojshme që ekzistojnë në hartë.
- 6.3 SKQZ-ja duhet të ketë mundësinë e procedimit të të dhënave në Harte, mundësinë e llogaritjes së distancës në mes të Lokacioneve të Qendrave të Votimit, përcaktimin e saktësisë për hartën e QV-ve. Të jetë e mundur futja e të dhënave në harte përmes GPS-së.

Neni 7

Publikimi i Qendrave të Votimit

- 7.1 Pas vlerësimit për Caktimin/Krijimin e QV-ve dhe në baze të rekomandimit të ZLKKZ/KKZ, KQZ përmes Sekretariatit të shpall publikisht Lokacionet e QV-ve, jo më vonë se Dyzet (40) dite para ditës së zgjedhjeve.
- 7.2 KQZ bën publikimin e Qendrave të Votimit në faqen zyrtare.

Neni 8

Dispozitat përfundimtare dhe kalimtare

Pjese përbërëse e kësaj rregulle është edhe shtojca:

Shtojca - I Formulari i Kërkesës për Themelimin e Qendrave të Votimit

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo rregull hyn në fuqi me datë 02. 07. 2013.

Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka



Shtojca I



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Data / Datum __ / __ / ____

Për / Za :

Nga / Od :

Kopje / Kopija:

Lënda / Predmet : Propozimi për Qendrën e Re të Votimit në (Vendi-Komuna)

Komuna :	Emri në shqip	Emri në serbisht
Kodi komunal		
Emri/Mbiemri i ZLKZ-së		

Qendra e Votimit e propozuar në :	Emri i vendbanimit	
	shqip	serbisht
P – Kodi		
Numri i Qendrës së Votimit		
Objekti i identifikuar		

Vendbanimet e	Emri i vendbanimit	P-Kodi	Përafërsisht
---------------	--------------------	--------	--------------

bashkangjitura të QV të propozuar	shqip	serbisht		votues ?
1				
2				
3				

Qendra e votimit ne Zgjedhjet e Kaluara	Emri i vendbanimit		P-Kodi	Votues ne Zgjedhjet e Kaluara
	Shqip	Serbishte		
1				
2				
3				

Bashkangjitur këtij formulari duhet te jene të dhënat si në vijim:

Madhësia ne m2	
Numri i dhomave	
Numri i kateve	
Gjendja e objektit	
Numri i hyrje/daljeve	
Tavolina/karrige	
Tualet	
Rryma	